

LIGJ
Nr.10 470, datë 13.10.2011

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 171, DATË 22.10.2009 “PËR
PROFESIONET E RREGULLUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.10 171, datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 11 bëhen këto ndryshime:

1. Pikat 3 dhe 4 ndryshohen si më poshtë:

“3. Autoriteti kompetent, në bashkëpunim me UP-në, kur ka një të tillë, bën regjistrimin e kandidatëve për kryerjen e praktikës profesionale dhe siguron që praktika të kryhet nën drejtimin e një profesionisti, i cili e ushtron profesionin prej jo më pak se tre vjetësh dhe jep garanci të mjaftueshme për përgatitjen teoriko-praktike të praktikantit.

Në përfundim të praktikës profesionale, kandidati i nënshtrohet “Vlerësimit për aftësimin praktik”, të organizuar dhe të zhvilluar nga autoriteti kompetent, nëpërmjet strukturave të veta. Praktika profesionale konsiderohet e kryer vetëm pas vlerësimit pozitiv të aftësimit praktik.

Modalitetet e organizimit të vlerësimit të aftësimit praktik përcaktohen në rregulloren e praktikës profesionale, që miratohet me urdhër të përbashkët të ministrit që mbulon fushën përkatëse dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

4. Gjatë zhvillimit të praktikës profesionale, praktikantit i paguhen sigurimet shoqërore dhe sigurimet shëndetësore nga subjekti pranë të cilit ai kryen praktikën profesionale.”.

2. Pika 5 shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 13, pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) tarifat e provimit të shtetit.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7142, datë 28.10.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi